



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 1234/6 prot.

Tiranë, më 24.07.2025

VENDIM

Nr. 23, datë 24.07.2025

PËR KONTROLLUESIN “DENTAL TURK”

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “*Dental Turk*” (në vijim, “*Kontrolluesi*”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 78, datë 17.04.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “*Komisioneri*”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- *Zbatim i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të hetimit, procesverbalin e hetimit administrativ dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nipt L21317045Q dhe ushtron aktivitetin si klinikë stomatologjike në zbatim të ligjit nr. 9928, datë 09.06.2008 “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kontrolluesi në kuadër të veprimtarisë që ushtron, përpunon të dhëna personale për kategoritë “pacientë”; “staf administrativ”; “mjek” etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi ka të instaluar një sistem video-survejsimi (CCTV), nëpërmjet të cilit mbikëqyrin korridoret, ambientet e jashtme dhe ambientet e brendshme të zyrave. Konstatohet se, kamerat janë pozicionuar në ambientet e brendshme të zyrave, në kundërshtim me parashikimet e neneve 6 dhe 7 të Ligjit dhe pikës 10.2 të Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 11”).

Nga verifikimi i kryer në vend konstatohet se, Kontrolluesi disponon tabelë informimi për mbikëqyrjen e ambienteve me sistemin CCTV, por nuk është sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri në kundërshtim me parashikimin e nenit 13 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 30.04.2025 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video-survejsimit” (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Sa më sipër, Kontrolluesi nuk informon qartësisht subjektet mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, nëpërmjet sistemit të video-survejsimit (CCTV), në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejsimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale, të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

Gjithashtu, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video survejsimit CCTV. Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si: “imazhe” e “video”, janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, mbikëqyrja e ambienteve të zyrave të punonjësve nëpërmjet sistemit të video survejsimit, është në kundërshtim me parashikimet e neneve 6 dhe 7 të Ligjit, si dhe Udhëzimin nr. 11 të Komisionerit.

3. Konstatohet se, Kontrolluesi ka të publikuar rubrikën “Politikat e Privatësisë” në faqen e internetit www.dentalurk.al. Nga analizimi i saj rezulton se, kjo rubrikë nuk është e aksesueshme për subjektet e të dhënave. Subjektet e të dhënave nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të

drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (për akses, korrigjim dhe fshirje) etj, në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

4. Kontrolluesi nuk disponon “*Rregullore për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash) sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, masat teknike dhe organizative etj, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të tij.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një rregulloreje specifike “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” përbën një detyrim thelbësor ligjor për çdo kontrollues, në zbatim të nenit 28 të Ligjit. Kjo rregullore duhet të përmbajë në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura mbi kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit, afatet e ruajtjes, të drejtat e subjekteve të të dhënave, si dhe përcaktimin e niveleve të aksesit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të kontrolluesit, duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

5. Kontrolluesi nuk aplikon për punëmarrësit “*Deklaratën e Konfidencialitetit*”, në përmbushje të detyrimit ligjor që buron nga neni 30 i Ligjit si dhe të Vendimit nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*”, (në vijim, “*Vendimi nr. 6*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, qëllimi i nënshkrimit të “*Deklaratës së Konfidencialitetit*” është që të gjithë punonjësit, të cilët kanë akses në të dhëna personale, të kuptojnë qartë dhe drejtë, detyrimet dhe përgjegjësitë që ata kanë mbi përpunimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

6. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit së Sigurisë së Informacionit (SMSI), për sa i takon mbrojtjes së të

dhënave personale, të parashikuar në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurtisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”*, (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*), si dhe në zbatim të nenit 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurtisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit *“Për certifikimin e sistemeve të sigurtisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 48”*) si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm me organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

7. Konstatohet se, Kontrolluesi përpunon në një shkallë të gjerë të dhënat sensitive të pacientëve, megjithatë nuk ka emëruar një nëpunës të mbrojtjes së të dhënave personale, në kundërshtim me nenin 33 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, caktimi i një nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale, është një detyrim i rëndësishëm që ka për qëllim garantimin e sigurtisë së të dhënave personale gjatë proceseve përpunuese që realizohen nga ana e Kontrolluesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Gjithashtu, bazuar në pikën 3, të nenit 34 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit në rastin e caktimit të një nëpunësi të mbrojtjes së të dhënave, në mënyrë që subjektet e të dhënave të mund ta kontaktojnë atë, për të gjitha çështjet që lidhen me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe ushtrimin e të drejtave të tyre, sipas këtij Ligji.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit nëpërmjet rrugës postare.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore, të zhvilluar më datë 01.07.2025, me shkresën administruar e me nr. 1234/5 prot., datë 01.07.2025, ka depozituar dokumentacion mbi konstatimet e procesverbalit të hetimit administrativ, si vijon:

- Kontratë pune së bashku me Deklaratën e Pëlqimit;
 - Marrëveshje Konfidencialiteti;
 - Dëshmi depozitimi.
- Lidhur me “*Marrëveshjen e Konfidencialitetit*”, Zyra e Komisionerit vlerëson se në pikën 6 të Vendimit nr. 6, parashikohet se, kontrolluesi detyrohet, për çdo punonjës, që kryesisht përpunon të dhëna sensitive të nënshkruajë “*Deklaratën e Konfidencialitetit*”, sipas modelit të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i dokumentit të depozituar, konstatohet se nuk është sipas modelit të vendimit nr. 6, të miratuar nga Zyra e Komisionerit.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se qëllimi i nënshkrimit të “*Deklaratës së Konfidencialitetit*” është që të gjithë punonjësit, të cilët kanë akses në të dhëna personale, të kuptojnë qartë dhe drejtë, detyrimet dhe përgjegjësitë që ata kanë mbi përpunimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të gërmas “a”, të pikës 1, të nenit 94 të Ligjit, si dhe gërmasve “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 94 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

“1. Bazuar edhe në rrethanat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të këtij ligji, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 1 000 000 000 (një miliard) lekë, ose në rastin e një shoqërie tregtare deri në 2% të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës, cilado është më e lartë, shkeljet e detyrimeve:

a) të kontrolluesit dhe përpunuesit, sipas neneve 8, pika 6, e 11, të kapitullit III, të pjesës II të këtij ligji, me përjashtim të nenit 22 të këtij ligji;.....

2. Bazuar edhe në rrethanat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 2 000 000 000 (dy miliardë) lekë, ose në rastin e një shoqërie tregtare, deri në 4% të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës, cilado që është më e lartë, shkeljet e mëposhtme:

a) moszbatimi i parimeve themelore të përpunimit, përfshirë kushtet për dhënien e pëlqimit, sipas neneve 6, 7, 8 e 9, të këtij ligji;

b) shkeljet e të drejtave të subjekteve të të dhënave sipas neneve 12–20 të këtij ligji;”.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit është bazuar në Udhëzimin nr. 06, datë 16.07.2025 për *“Miratimin e metodologjisë për përlllogaritjen e masës së sanksioneve administrative”*, pikat 7 dhe 8, të sesionit 2.3 të kapitullit 2. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ka marrë në konsideratë pasqyrën financiare të Kontrolluesit të deklaruar në regjistrin tregtar për të dhënat e subjektit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, rëndësinë e proceseve përpunuese, si dhe mënyrën e reagimit dhe të bashkëpunimit të Kontrolluesit të cilat nuk janë adresuar sipas Ligjit. Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave, me informimin dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjen e masave të përshtatshme tekniko-organizative për sigurinë e të dhënave personale. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 7, 13, 28, 30, 33, 34, 81, 82, 83, 84, 93, pika 1, germa “a” dhe pika 2, germat “a” dhe “b” të nenit 94 , si dhe nenin 95 të Ligjit,

V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 6 të Ligjit;
- 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit;
- 3- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 900.000 (nëntëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 13 të Ligjit;
- 4- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 300 000 (treqindë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të Ligjit;
- 5- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 30 të Ligjit;
- 6- Kontrolluesi të ndalojë menjëherë përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale përmes sistemit të survejimit CCTV në ambientet e punës së punonjësve, si dhe të shkatërrojë në mënyrë të parikuperueshme të dhënat “video/audio” të mbledhura për subjektet e të dhënave “punonjës”, të cilat janë përpunuar, në kundërshtim me dispozitat e neneve 6 dhe 7 të Ligjit. Në këtë kuadër të mbajë evidenca për shkatërrimin;

- 7- Kontrolluesi, të marrë masa për publikimin e “*Politikave të Privatësisë*” në faqen e internetit, në lidhje me informimin e subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;
- 8- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të marrë masa për hartimin e rregullores “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, duke parashikuar në të, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
- 9- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 30 të Ligjit, të aplikojë “*Deklaratën e Konfidencialitetit*” me punëmarrësit të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale;
- 10- Kontrolluesi të marrë masa për caktimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 34 të Ligjit, si dhe të njoftojë Komisionerin për caktimin e tij;
- 11- Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale si dhe krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;
- 12- Kontrolluesi, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme për të vlerësuar mbi certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48;
- 13- Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
- i. menjëherë, detyrimin e përcaktuar në pikën 6 më sipër;
 - ii. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 7 dhe 9 më sipër;
 - iii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 8 dhe 10 më sipër;
 - iv. brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 11 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

- 14- Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;

- 15-** Gjeba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit;
- 16-** Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 24.07.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi